

Fillimi > -Kronikë

Të shtëna me armë zjarri në Tiranë, 42-vjeçari dhunon të atin dhe kërcënon me jetë policët, kapet pas disa orësh ndjekjeje

21 Prill, 2020 11:34 |



Madhësia e tekstit: - +

Njëskenë si nëpër filma ka ndodhur në një familje, në Tiranë. Një 42-vjeçar ka dhunuar babanë, ka qëlluar me armë zjarri brenda banesës, duke terrorizuar familjarët, dhe më pas ka kanosur me armë edhe punonjësit e policisë.

PAGESA DHE TRANSPORTA PËR BIZNESIN TËND?

McAfee Internet Security Protect unlimited devices **BUY NOW**

Me të mbërritur në banesë, policët i kanë bërë thirrje të lëshojë armën dhe të dorëzohet, por shtetasi R. L. i ka kërcënuar me jetë për të mos u afruar në banesë, pasi do t'i qëllonte me armë zjarri, por më pas është larguar nga banesa me shpejtësi.

“Në ndjekje të tij janë vënë forca të shumta të Komisarariatit të Policisë Nr. 6 dhe pas disa orë ndjekjeje dhe kontrollesh kanë bërë të mundur kapjen e tij në një banesë të braktisur, si dhe sekuestrimin e armës së zjarrit.”, thotë policia.

Njoftimi i plotë:

Tiranë

Dhunoi babanë dhe qëlloi me armë zjarri në banesë, ndërhyrja në kohë e shërbimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 6 parandaloi përshkallëzimin e mëtejshëm, duke evituar një ngjarje të rëndë kriminale.

Në momentin e ndërhyrjes së Policisë, 42-vjeçari i ka kanosur me jetë punonjësit e Policisë dhe ka tentuar të largohet duke përfutur nga errësira, por është kapur pas disa orësh ndjekjeje dhe kontrolli nga shërbimet e Policisë.

Sekuestrohet arma e zjarrit pistoletë, me të cilën autori qëlloi në banesë.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 6 kanë marrë njoftim se ne fshatin Bulticë, Njësia Administrative Vaqarr, në banesën e shtetasit Sh. L., 64 vjeç, kishte të shtëna me armë. Menjëherë, në drejtim të adresës së dhënë nga qytetarët, janë nisur shërbimet e Policisë.

Në momentin që shërbimet e Policisë janë afruar për të hyrë në banesë, shtetasi R. L., 42 vjeç, djali i shtetasit Sh. L, ka kërcënuar me jetë punonjësit e Policisë për të mos u afruar në banesë, pasi do t'i qëllonte me armë zjarri.

Shërbimet e Policisë i kanë bërë thirrje 42-vjeçarit që të dorëzohej dhe të hidhte armën, por shtetasi R. L. ka mundur të dalë nga banesa nga një dalje dytësore dhe duke përfutur nga errësira është larguar me shpejtësi.

Në ndjekje të tij janë vënë forca të shumta të Komisarariatit të Policisë Nr. 6 dhe pas disa orë ndjekjeje dhe kontrollesh kanë bërë të mundur kapjen e tij në një banesë të braktisur, si dhe sekuestrimin e armës së zjarrit.

Shtetasi R. L., pas një konflikti me babanë e tij, shtetasin Sh. L, ka qëlluar me armë zjarri pistoletë në banesë, por pa shkaktuar pasoja.


Në përfundim të veprimeve u bë arrestimi i shtetasit R. L., për veprat penale “Dhuna ne familje” dhe “Armëmbajtja pa leje” dhe materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)


Etiketa: arme zjarri dhune ne familje Tirane

TË NGJASHME



“Shkodrançe më ke pritë”, poeti kosovar i thurr vargë në Britani, Ljarjes: Unë s'paskom pse me ardhë n'Myslim Shyri, ti s'qenke ma n'Tiranë

21 Prill, 2020



21 Prill, 2020

“Sherri nisi për alkoollin”, zbardhet dëshmia e 42-vjeçarit që dhunoi të atin dhe qëlloi me armë brenda banesës

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË




22 Prill, 2020

EMRAT/ Shqiptarët kapen me 300 mijë paund drogë në Britani, dëshmia në gjykatë: Nuk e dija që ishin bimë narkotike...




22 Prill, 2020

KLQJ merr vendimin: Më 27 prill rifillon puna në të gjitha gjykatat e vendit, ja çfarë duhet të dinë kryetarët



22 Prill, 2020

OFL rikthehet në terren për goditjen e pasurive kriminale, sekuestron 9 automjete dhe një pasaportë



22 Prill, 2020

Leje pune për lëvizje në Itali/ Furnitori shqiptar i kafesë kapet me 4,5 kg kokainë, por nuk mbaron me kaq...



22 Prill, 2020


Shkon në 27 numri i viktimave nga koronavirusi, ndërrojnë jetë i moshuari te “Shefqet Ndroqi”



22 Prill, 2020


Detaje nga abuzimi me të miturën në Sarandë, 17-vjeçarja i pastronte dhe gatuante të moshuarit, ja kush e bindi për të denoncuar

KATEGORIA VIDEO



22 Prill, 2020

VIDEO/ Paralamjëron zbutjen e masave në varësi të hartës së COVID-19, Rama: Javën e ardhshme përpilojmë lehtësimet për zonat me risk të ulët




22 Prill, 2020

“Kemi më shumë se 100 vatra aktive”, Manastirliu flet për planin e rihapjes: Do të kalojë në 4 faza, masat lehtësuese me afat kohor prej 2 javësh (Video)



22 Prill, 2020

Petrit Vasili: Menaxhim spontan i COVID 19 në Shqipëri. Qeveria po fsheh të vërtetën



22 Prill, 2020

Bona Miekley nga MOPS Europe: T'u krijojmë fëmijëve kujtime të shëndetshme!



22 Prill, 2020

Video/ “Nuk kemi frikë, do vijojmë përpara”, e pazakontë në Nartë festohen karnavalet në kohë pandemie



21 Prill, 2020

Liria e medias/ Arrestimi i vajzës në Durrës për përhapje paniku, Peza: Shkeli ligjin, tmerrroi njerëzit duke i nxjerrë në rrugë...